



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*  
*Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry Of*  
*Internal Affairs*

# Strategjia dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e Armëve të vogla, të lehta dhe Eksplozivëve 2017 – 2021

## Përmbledhje ekzekutive

Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet ende e përkushtuar për menaxhimin, kontrollin dhe luftën kundër trafikimit të armëve të vogla, të lehta (AVL), eksplozivëve e prekursorëve të tyre. Trafikimi dhe posedimi i paligjshëm, krimet me armë, eksplozivët dhe prekursorët e tyre, edhe pse paraqitet në rënie cdo vit, ende shfaqet si kërcënim për jetën njerëzore dhe rendin e sigurinë publike. Kur armët e paligjshme, municioni dhe eksplozivët analizohen në kontekst të sigurisë dhe kërcënimeve nacionale, siç është lufta kundër terrorit, atëherë kontrolli, menaxhimi si dhe lufta ndaj paligjshmërisë të këtij sektori merr një dimension të ri të cilit duhet kushtuar vëmendje dhe resurse të veçanta.

Ndër-veprimi dhe bashkëpunimi mes grupeve kriminale me ato terroriste nuk njih kufij ndarës andaj edhe qasja e kësaj strategjie është gjithëpërfshirëse. Përveç kërkesave të brendshme për rritjen e sigurisë publike, Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes kësaj strategjie do të kontribuojë edhe në sigurinë rajonale dhe të BE-së nëpërmjet kontrollit kufitar si dhe duke luftuar eksportet dhe importet e paligjshme të armëve, municionit, eksplozivëve dhe prekursorëve të tyre. Nëse deri tani institucionet e sigurisë ishin të koncentruara në ndalimin dhe luftimin e importeve të paligjshme në **pikat kufitare hyrëse**, tani do të aplikojnë të njëjtën qasje edhe në **pikat kufitare dalëse** të Republikës së Kosovës.

**Lufta kundër terrorit** na obligon që përveç kontrollit, menaxhimit dhe luftimit të paligjshëm të armëve, municionit dhe eksplozivëve të krijojmë **masa shtesë** të kontrollit dhe mbikqyrjes së personelit dhe personave juridik shtetërore e private të cilët importojnë, deponojnë dhe përdorin **eksplozivët e prekursorët** e tyre. Ngritja e mëtutjeshme e kapaciteteve institucionale dhe të sistemeve të monitorimit e paralajmërimit të hershëm do të kenë vëmendje të veçantë.

Republika e Kosovës nga viti 2008 ka bërë përparim të jashtëzakonshëm në fushën e armëve dhe eksplozivëve. Janë hartuar 2 ligje që rregullojnë fushën e armëve si dhe ekziston Ligji për përdorimin civil të eksplozivëve. Për zbatimin e këtyre Ligjeve janë hartuar 30 Udhëzime Administrative. Po ashtu, viti 2016 shënon vitin e tetë kur është hartuar Strategjia e parë për Kontrollin dhe Mbledhjen e Armëve të Vogla dhe të Lehta (2008 -2012) më pas Strategjia e dytë (2013-2016). Gjatë këtyre viteve janë krijuar mekanizma adekuat për zbatimin e legjislacionit që rregullon tregtimin, posedimin, gjurmimin, importin e armëve dhe eksplozivëve për sektorin privat dhe sektorin qeveritar. Shënjimi dhe gjurmimi i armëve është funksional dhe me standarde të larta. Agjencia e Kosovës për Forenzikë është pajisur me sistemin teknologjik IBIS dhe prodhon edhe të dhëna inteligjente. Është themeluar pika kontaktuese nacionale për armët e zjarrit (FFP)<sup>1</sup> e cila vepron në kuadër të ILECU<sup>2</sup>-s, funksion ky i cili do të prodhojë analiza bazuar në të dhëna të inteligjencës dhe shërben si pikë kontaktuese ndër-institucionale dhe ndërshtetërore.

---

<sup>1</sup> Në rrethet profesionale njih et si FFP – *Firearms Focal Point*

<sup>2</sup> Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit – ILECU, Raport Analitik për Armët në Kosovë (2013-2016)



Republika e Kosovës është pjesëmarrës i rregullt në iniciativat rajonale<sup>3</sup> që kanë për objekt kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta në rajonin e Evropës Juglindore, përkatësisht vendet e Ballkanit Perëndimor. Tregtimi i paligjshëm me armë e municione si dhe krimet me armë kanë shënuar rënie të konsiderueshme krahasuar me vitet paraprake<sup>4</sup>. Institucionet e Kosovës kanë themeluar mekanizmat adekuat për luftimin e trafikimit të paligjshëm të cilat kanë arritur me sukses të identifikojnë rrugët kryesore të trafikimit<sup>5</sup>. Republika e Kosovës njihet si vend me sukses të konsiderueshëm, për konfiskimin dhe shkatërrimin e armëve të konfiskuara me një mesatare vjetore prej 1,600 armëve<sup>6</sup>.

Në këtë kontekst Qeveria e Republikës së Kosovës, përveç që do të ruaj progresin e arritur, më këtë Strategji dhe Plan Veprimi pesë vjeçar (2017 – 2021) do të zhvillojë më tutje politikën dhe kornizën ligjore të saj. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e Armëve të vogla, të lehta dhe Eksplozivëve merr parasysh çështjet e sigurisë nacionale në Republikën e Kosovës dhe i adreson përmes këtyre objektivëve strategjik:

- **Objektivi Strategjik 1:** Zhvillimi i mëtutjeshëm i legjislacionit dhe politikave;
- **Objektivi Strategjik 2:** Qasje gjithëpërfshirëse për zvogëlimin e rreziqeve nga armët dhe eksplozivët që cenojnë sigurinë dhe rendin publik;
- **Objektivi Strategjik 3:** Zhvillimi i mëtutjeshëm i kapaciteteve institucionale dhe hulumtuese;
- **Objektivi Strategjik 4:** Koordinimi ndër-institucional dhe rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar.

---

<sup>3</sup> SEESAC - <http://www.seesac.org/search/?search=Kosovo>

<sup>4</sup> Raport për Armët në Kosovë (2013-2016) - Analiza e FFP - ILECU

<sup>5</sup> Analiza e QKMK – Njësia e Përbashkët për Inteligjencë, Analizë të Rrezikut dhe Kërcënimeve (NJPIARK)

<sup>6</sup> Raport për Armët në Kosovë (2013-2016) - Analiza e FFP - ILECU



## Përmbajtja

<b>1</b>	<b>Hyrje .....</b>	<b>6</b>
1.1	Qëllimi.....	6
1.2	Vizioni.....	6
<b>2</b>	<b>Metodologjia.....</b>	<b>7</b>
<b>3</b>	<b>Sistemi i Menaxhimit të Strategjisë dhe Raportimi.....</b>	<b>8</b>
3.1	Cikli pesëvjeçar i Strategjisë.....	8
3.2	Kërcënimet ndaj sigurisë së brendshme dhe obligimet në procesin integruar në BE .....	8
<b>4</b>	<b>Parimet e përgjithshme .....</b>	<b>10</b>
<b>5</b>	<b>Korniza ligjore dhe mekanizmat institucional .....</b>	<b>12</b>
5.1	Korniza ligjore .....	12
5.2	Mekanizmi institucional .....	13
<b>6</b>	<b>Objektivat e Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta dhe Eksplozivëve .....</b>	<b>16</b>
<b>7</b>	<b>Implementimi, monitorimi dhe vlerësimi i Strategjisë .....</b>	<b>21</b>
7.1	Roli i sistemit të monitorimit .....	21
7.2	Kapacitetet institucionale për monitorim e vlerësim .....	21
7.3	Indikatorët për monitorim dhe vlerësim .....	21
<b>8</b>	<b>Plani i Veprimit 2017-2021 .....</b>	<b>23</b>



## Lista e shkurtesave

<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>DPS</b>	Departamenti për Siguri Publike
<b>MF</b>	Ministria e Financave
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MTI</b>	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
<b>AKI</b>	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>MPJ</b>	Ministria e Punëve të Jashtme
<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>AKF</b>	Agjencia e Kosovës për Forenzikë
<b>DK</b>	Dogana e Kosovës
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>OKB</b>	Organizata e Kombete të Bashkuara
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
<b>OSBE</b>	Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
<b>KiE</b>	Këshilli i Evropës
<b>OJQ</b>	Organizata Joqeveritare
<b>AVL</b>	Armët e Vogla dhe të Lehta
<b>FFP</b>	Pika Kontaktuese Nacionale
<b>DIEKP</b>	Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
<b>QKMK</b>	Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar
<b>NJPIARK</b>	Njësia e Përbashkët për Inteligjencë, Analizë të Rrezikut dhe Kërcënimeve
<b>GCKD</b>	Grupi për Caktim dhe Koordinim të Detyrave
<b>KPMM</b>	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
<b>VKKRO</b>	Vlerësimet të Kërcënimit nga Krimet e Rënda dhe të Organizuara
<b>ILECU</b>	Njësia e Bashkëpunimit Ndërkombëtarë për Sundimin e Ligjit
<b>SEESAC</b>	Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta
<b>SEEFEN</b>	Rrjeti i Evropës Juglindore i Ekspertëve të Armëve të Zjarrit
<b>SEEFEG</b>	Grupi i Evropës Juglindore i Ekspertëve të Armëve të Zjarrit



## **1 Hyrje**

### **1.1 Qëllimi**

Në tetor të vitit 2013, Qeveria miratoi Strategjinë për Kontrollimin dhe Mbledhjen e Armëve të Vogla dhe Planin e Veprimit (2013-2016)<sup>7</sup>. Qeveria u angazhua për të siguruar përditësim vjetor mbi progresin e zbatimit të Strategjisë<sup>8</sup>. Qëllimi kryesor i kësaj Strategjie pesëvjeçare (2017-2021) ende mbetet kontrolli i plotë mbi armët e vogla dhe të lehta si dhe eksplozivët, duke u bazuar në kërkesat vendore dhe standardet e BE-së, OKB-së dhe OSBE-së.

Sigurisht se ky dokument strategjik ka për qëllim, po ashtu, të caktojë orientime të përgjithshme për organizatat dhe Agjencitë të cilat zbatojnë aktivitete të Strategjisë për pesë vitet vijuese në Republikën e Kosovës. Për më tepër, ky dokument paraqet vizionin e Qeverisë së Kosovës për kontrollin e armëve, municionit dhe eksplozivëve dhe planin përkatës të veprimit. Kjo Strategji është pjesë e Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2016 dhe Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Republika e Kosovës është zotuar të promovojë stabilitetin dhe sigurinë, jo vetëm brenda vendit, por edhe të jetë kontribuuese e rëndësishme ndaj sigurisë së rajonit dhe më gjerë. Kështu, bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e kontrollit dhe luftës kundër trafikimit të paligjshëm me AVL-të dhe Eksploziv mbetet një nga prioritetet e Qeverisë, përkatësisht të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

### **1.2 Vizioni**

Republika e Kosovës do të sigurojë një mjedis të sigurt në të cilin AVL-të si dhe eksplozivët janë nën kontroll dhe nuk paraqesin rrezik serioz për sigurinë e brendshme dhe atë rajonale po ashtu.

---

<sup>7</sup> <http://mpb.rks-gov.net/Documents/Acrobat%20Document-8.pdf>

<sup>8</sup> [http://preportr.cohu.org/repository/docs/Plani\\_i\\_Veprimit\\_Kombetar\\_te\\_Republikes\\_se\\_Kosoves\\_per\\_Kontrollin\\_dhe\\_Grumbullimin\\_e\\_Armeve\\_te\\_Vogla\\_dhe\\_te\\_Lehta\\_752702.pdf](http://preportr.cohu.org/repository/docs/Plani_i_Veprimit_Kombetar_te_Republikes_se_Kosoves_per_Kontrollin_dhe_Grumbullimin_e_Armeve_te_Vogla_dhe_te_Lehta_752702.pdf)



## 2 Metodologjia

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e AVL-të dhe Eksplozivët (2017 – 2021) është hartuar duke u mbështetur në vlerësimet dhe analizat e agjencive të specializuara<sup>9</sup>, të dhënave statistikore nga institucionet qeveritare dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare<sup>10</sup> që veprojnë në Kosovë dhe jashtë saj. Po ashtu kjo strategji është mbështetur në kërkesat e Bashkimit Evropian të cilat burojnë nga “**Plani i Veprimit të BE-së kundër trafikimit dhe përdorimit të armëve të zjarrit dhe eksplozivëve**”<sup>11</sup> si dhe **Vendimit të Këshillit 2013/730/CFSP**<sup>12</sup>, datë 9 dhjetor 2013. Kjo Strategji është bazuar në praktikat dhe standardet tjera ndërkombëtare (OKB/ISACS). Në këtë kontekst, kjo Strategji tenton të jetë në harmoni me standardet dhe rregulloret përkatëse të BE-së dhe ato ndërkombëtare.

Ministri i Punëve të Brendshme me Vendimin nr. 196/2016, datë 01.07.2016 ka emëruar Koordinatorin Nacional si dhe ka themeluar Grupin Punues për hartimin e Strategjisë me Vendimin Nr. 305/2016 të datës 04.11.2016 në të cilin janë përfshirë institucionet kryesore shtetërore.

Nga 16-18 tetor 2016, është mbajtur punëtoria për hartimin e Strategjisë e mbështetur nga Projekti KOSSAC i UNDP. Të gjithë përfaqësuesit kanë pasur mundësinë që të ofrojnë propozimet e tyre dhe diskutojnë mbi Strategjinë dhe aktivitetet e Planit të Veprimit. Grupi Punues ka hartuar draftin e Strategjisë dhe ka ndarë këtë draft me disa palë të interesit të cilat përfshijnë organizata jo qeveritare dhe partnerë ndërkombëtar si dhe sektorin privat, po ashtu.

---

<sup>9</sup> DSP – ILECU – QKMK – KOSSAC/UNDP.

<sup>10</sup> Forumi për Siguri (2012): Kontrolli i armëve të vogla dhe të lehta në Kosovë: Progresi dhe Sfidat [http://www.fiq-fci.org/repository/docs/Kontrolli\\_i\\_AVL-ve\\_ne\\_Kosove\\_progresi\\_dhe\\_sfidat.pdf](http://www.fiq-fci.org/repository/docs/Kontrolli_i_AVL-ve_ne_Kosove_progresi_dhe_sfidat.pdf)

<sup>11</sup> Komisioni Evropian (2015) - [http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/policies/european-agenda-security/legislative-documents/docs/20151202\\_communication\\_firearms\\_and\\_the\\_security\\_of\\_the\\_eu\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/policies/european-agenda-security/legislative-documents/docs/20151202_communication_firearms_and_the_security_of_the_eu_en.pdf)

<sup>12</sup> Këshilli i Bashkimit Evropian (2013) - <http://publications.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/d1fece18-6241-11e3-ab0f-01aa75ed71a1/language-en>




### 3 Sistemi i Menaxhimit të Strategjisë dhe Raportimi

#### 3.1 Cikli pesëvjeçar i Strategjisë

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta dhe Eksplozivëve është hartuar për një cikël 5 vjeçar, i cili përfshin fazat vijuese:

1. Zhvillimi;
2. Zbatimi;
3. Vlerësimi;
4. Përshtatja e Strategjisë dhe aktiviteteve.

Kjo mënyrë siguron përparim të vazhdueshëm të Strategjisë, procedurave dhe rezultateve, si dhe ofron mundësitë për ndryshim sipas rrethanave që mund të paraqiten në mjedisin e afërt dhe të largët.



#### 3.2 Kërcënimet ndaj sigurisë së brendshme dhe obligimet në procesin integruar në BE

Armët e Vogla dhe të Lehta, nëse nuk kontrollohen, mund të paraqesin kërcënim për sigurinë e brendshme dhe vendi të klasifikohet si vend tranzit apo burim i rreziqeve për rajonin dhe BE-në. Armët ndikojnë tek njerëzit, komunitetet dhe bizneset si dhe vazhdojnë të shkaktojnë humbje të jetëve, dëme ekonomike dhe sociale si dhe frikë për publikun.





Deri më 31 dhjetor 2014, sipas Anketimit për Armët e Vogla, është vlerësuar se ka pasur rreth 260,000 armë të paligjshme në duar të personave civil<sup>13</sup>. Kjo tregon që ka pasur një zvogëlim të madh që nga vlerësimi i fundit i kryer në vitin 2007 (310.000 deri 440.000 armë)<sup>14</sup>, por gjithashtu tregon se afërsisht 1 në shtatë qytetarë posedojnë armë të paligjshme në Kosovë, ndërsa 15 njerëz kanë humbur jetën për shkak të dhunës me armë të zjarrit gjatë vitit 2015. Gjatë vitit 2015, në përputhje me Kodin Penal të Kosovës tek Policia e Kosovës janë raportuar 1500 raste të krimeve të kryera me armë.

Strategjia e bën të qartë që reagimi ynë ndaj incidenteve të shkaktuara nga armët drejtohet nga të kuptuarit autoritativ lidhur me kërcënimin. Gjatë vitit 2015, Policia e Kosovës filloi për herë të parë hartimin e Vlerësimit të Kërcënimit nga Krimet e Rënda dhe të Organizuara (VKKRO) dhe Ministria e Punëve të Brendshme filloi zbatimin e studimit për gjurmim të municionit, dhe bëri një sondazh të ri mbi armët e vogla, që mbulon perceptimin për AVL-të, shpërndarjen, kapacitetin si dhe raportin e analizave të krimit me armë, në përputhje me Ligjin për armët<sup>15</sup>. Gjithashtu, është implementuar një ekzaminim i veçantë balistik për armët e konvertuara të cilat përdoren për krime në Kosovë<sup>16</sup>. Sidoqoftë, këto dokumente shfaqin pasqyrën më të plotë të kërcënimeve nga krimet e shkaktuara nga AVL-të me të cilat përballet Kosova.

Për më tepër, Parlamenti Evropian në rezolutën e tij për procesin e integritetit të Kosovës në Evropë (2014/2950 (RSP) të datës 2 mars 2015 thotë: "gjithashtu është shqetësuese pronësia e përhapur e armëve të paligjshme dhe i bën thirrje Qeverisë së Kosovës që të fillojë programe për mbledhjen e këtyre armëve të zjarrit; të bashkëpunoj me grupin e ekspertëve të BE-së për trafikimin e armëve dhe me shtetet fqinje për të marrë masat parandaluese, dhe gjithashtu i bën thirrje BE-së të ofrojë çfarëdo forme të nevojshme të asistencës teknike për këtë gjë"<sup>17</sup>; dhe

Raporti i tretë i progresit të Kosovës sa i përket plotësimit të kërkesave të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave, të datës 18 dhjetor 2015 thotë: "Kosova është duke adresuar trafikimin e armëve, por shkalla e shkatërrimit të armëve të vogla mbetet e ulët. Në mënyrë që të rritet efikasiteti i përpjekjeve kundër trafikimit të armëve të zjarrit, Kosova duhet të priorizoj zbatimin e të gjitha veprimeve të dakorduara në Planin e Veprimit mbi trafikimin e paligjshëm të armëve të zjarrit ndërmjet BE-së dhe Rajonit të Evropës Juglindor"<sup>18</sup>.

Andaj është paraparë që kjo Strategji ta ketë për vizion që "Republika e Kosovës dao të sigurojë një mjedis të sigurt në të cilin armët e vogla, të lehta si dhe eksplozivet janë nën kontroll dhe nuk paraqesin rrezik serioz për sigurinë e brendshme dhe atë rajonale, po ashtu".

<sup>13</sup> Small Arms Survey (2014), faqe 5 - <http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/G-Issue-briefs/SAS-AV-IB4-Western-Balkans.pdf>

<sup>14</sup> SEESAC: SALW Survey of Kosovo, faqe 2 - <http://www.seesac.org/f/tmp/files/publication/422.pdf>

<sup>15</sup> UNDP (2015). Hulumtim për armët e vogla dhe të lehta, raport i papublikuar.

<sup>16</sup> AKF & Arqebus (2015). Weapon & Tool Mark Examination.

<sup>17</sup> Parlamenti Evropian (2015) - <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//NONSGML+TA+P8-TA-2015-0066+0+DOC+PDF+V0//EN>

<sup>18</sup> Komisioni Evropian (2015) - [http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/e-library/documents/policies/internationalaffairs/general/docs/third\\_report\\_progress\\_kosovo\\_fulfilling\\_requirements\\_visa\\_liberalisation\\_roadmap\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/e-library/documents/policies/internationalaffairs/general/docs/third_report_progress_kosovo_fulfilling_requirements_visa_liberalisation_roadmap_en.pdf)



#### 4 Parimet e përgjithshme

Struktura dhe përmbajtja e këtij dokumenti bazohet në këto parime:

**Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë** - veprimet e ndërmarra duhen bazuar në dispozitat e parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

**Parimi i sigurisë shtetërore** - kontrolli i AVL-ve dhe Eksplozivëve është pjesë përbërëse e sigurisë shtetërore, mbështet funksionimin e shtetit dhe shoqërisë të bazuar në rend dhe ligj, konkurrueshmërinë së ekonomisë dhe inovacionin, po ashtu. Ky parim nënkupton mbrojtjen e të drejtës për siguri dhe mbrojtje për të gjithë qytetarët, përmes parandalimit, luftimit dhe kontrollit.

**Parimi i të drejtave dhe lirive të njeriut** -garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, duke garantuar të drejtat dhe liritë themelore, si dhe duke mbrojtur liritë individuale, informatat personale, si dhe identitetin, pa marrë parasysh etninë, gjininë, moshën, fenë dhe orientimin seksual. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë të jetojnë në një mjedis të mbrojtur dhe të sigurtë nga keqpërdorimi i AVL-ve.

**Parimi i përgjegjësisë** - për shkak të kompleksitetit, shteti nuk mund të mbajë përgjegjësinë si i vetëm për parandalimin, mbrojtjen dhe vetëdijësimin ndaj rrezikut që paraqet keqpërdorimi i AVL-ve dhe eksplozivëve. Andaj, pjesë të ndryshme të shoqësisë dhe sektori privat kanë përgjegjësi, po ashtu, për parandalimin, mbrojtjen dhe vetëdijësimin ndaj rrezikut nga AVL-të dhe eksplozivët.

**Parimi i qasjes së gjithmbarshme** - është qenësore të zhvillohet një qasje e gjithmbarshme në përballje me kërcënimet nga AVL-të dhe Eksplozivët që paraqiten si rrezik ndaj sigurisë së brendshme.

**Parimi i partneritetit publiko-privat** - Legjislacioni vendor lejon tregtimin dhe posedimin e armëve dhe eksplozivëve nga sektori privat. Duhet kontribuar në mënyrë të përbashkët dhe të bashkërenduar ndërmjet sektorit privat dhe atij publik për zbatimin e kësaj strategjie.

**Parimi i vazhdimësisë** - aktivitetet duhen parë si pjesë e një strategjie paraprake dhe të vazhdueshme. Kjo ka rëndësi të veçantë sepse do të ketë afate administrative, procedurale dhe kohore, si dhe për shkak se iniciativat e veprimet e ndryshme duhen ndërlidhur me veprime të cilat mund të vazhdojnë për vite me radhë.

**Parimi i konfidencialitetit** - institucionet me përgjegjësi në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me armë dhe eksplozive duhet të krijojnë dhe ruajnë besimin për hetime, të të dhënave konfidenciale dhe integritetit të informatave nga keqpërdorimi nga ata që kanë qasje në to.

**Parimi i të Drejtës për t'u informuar** - do të aplikohet për të informuar të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës për rreziqet dhe pasojat nga AVL-të dhe Eksplozivët si dhe informimi mbi aktivitetet institucionale për krijimin e një ambienti më të sigurtë.



**Parimi i bashkëpunimit ndërkombëtar** - lufta kundër trafikimit të paligjshëm me AVL dhe Eksplozive si dhe standardizimi i legjislacionit dhe praktikave avancohet përmes bashkëpunimit ndërkombëtar me partnerë dhe aleatë. Përmes bashkëpunimit, Republika e Kosovës do të luajë rol qenësor në promovimin e sigurisë së shteteve të veçanta dhe sigurisë rajonale.



## 5 Korniza ligjore dhe mekanizmat institucional

### 5.1 Korniza ligjore

Në fushën e kontrollit të AVL-ve dhe Eksplozivëve, Republika e Kosovës ka në zbatim një bazë të gjerë ligjore, e cila përfshin por nuk kufizohet në:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës<sup>19</sup>;
- Ligji nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës<sup>20</sup>;
- Ligji nr.03/L - 172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<sup>21</sup>;
- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë<sup>22</sup>;
- Ligji nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësinë Publike<sup>23</sup>;
- Ligji nr. 03/L063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë<sup>24</sup>;
- Ligji nr. 03/ L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare<sup>25</sup>;
- Ligji nr. 04/L-213 për Ndihmën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale<sup>26</sup>;
- Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare<sup>27</sup>;
- Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror<sup>28</sup>;
- Ligji nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë<sup>29</sup>;
- Ligji nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike<sup>30</sup>;
- Ligji nr.04/L -004 për Shërbimet Private të Sigurisë<sup>31</sup>;
- Ligji nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës<sup>32</sup>;
- Ligji nr. 03/L-109 për Kodin Doganor dhe të Akcizave të Kosovës<sup>33</sup>;
- Ligji nr. 04/L-099 për Ndryshim-Plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë, nr. 03/L-109<sup>34</sup>;
- Ligji nr.03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë<sup>35</sup>;
- Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës<sup>36</sup>;
- Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale<sup>37</sup>;
- Rregullore nr.18/2011 për Shpërndarjen dhe Transferimin e Informacionit të Klasifikuar<sup>38</sup>.

---

<sup>19</sup> <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

<sup>20</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2521>

<sup>21</sup> <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2676>

<sup>22</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806>

<sup>23</sup> <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2651>

<sup>24</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2538>

<sup>25</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2674>

<sup>26</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8871>

<sup>27</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2789>

<sup>28</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2801>

<sup>29</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2781>

<sup>30</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8860>

<sup>31</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2741>

<sup>32</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2523>

<sup>33</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2600>

<sup>34</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2600>

<sup>35</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2690>

<sup>36</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834>

<sup>37</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

<sup>38</sup> <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10554>



- Ligji mbi Armët, municionin dhe pajisjet përkatëse të sigurisë për institucionet shtetërore të sigurisë<sup>39</sup>;
- Ligji mbi Armët<sup>40</sup>;
- Ligji mbi Gjuetinë<sup>41</sup>;
- Ligji mbi Përdorimin Civil të Eksplozivëve<sup>42</sup>;

## 5.2 Mekanizmi institucional

Mekanizmi institucional nënkupton të gjithë mekanizmat të cilët kanë rol dhe rëndësi primare dhe sekondare në zbatimin e strategjisë. Mekanizmat institucional për hartimin dhe zbatimin e strategjisë janë evidentuar si më poshtë, por nuk kufizohen në:

### **Koordinatori Nacional për Kontrollin dhe mbledhjen e AVL-ve**

Koordinatori Nacional është Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, ose personi i autorizuar nga Ministri, i cili është përgjegjës të bashkërendojë, udhëzojë, monitorojë dhe të raportojë për zbatimin e politikave, aktiviteteve dhe veprimeve në lidhje me Strategjinë dhe Planin e Veprimit për kontrollin e AVL-ve dhe Eksplozivëve 2017-2021.

### **Departamenti për Siguri Publike - Ministria e Punëve të Brendshme**

DSP ka rolin primar dhe është përgjegjëse për propozimin, hartimin, monitorimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e armëve dhe eksplozivëve. DSP menagjon me bazat e të dhënave SACON<sup>43</sup>-s dhe EXPLOCON<sup>44</sup> si dhe kryeson me Komisionin Nacional për shqyrtimin e aplikimeve për, tregtimin, eksportin dhe aplikimeve/kërkesave relevantë për leje dhe licencime të cilat dalin nga Ligji për Armë dhe Ligji PQV.

### **Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave**

DIEKP do të ketë rol primar në përmbledhjen dhe publikimin e raporteve vjetore për aktivitetet e Strategjisë dhe do të luaj rolin e zyrës koordinuese për këtë Strategji, duke ushtruar funksionin e saj primar të koordinimit dhe ndërlidhjen e tyre me dokumente strategjike si dhe raportimet për zbatimin e Planit Vjetor të Qeverisë si dhe në raportimet për procesin e integritimit në BE.

### **Policia e Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme**

PK është agjenci për zbatimin e ligjit në kuadër të MPB-së, dhe ka jo vetëm përgjegjësinë kryesore në luftimin e të gjitha formave të krimit, por posedon me kapacitete të specializuara në fusha të veçanta si dhe struktura mbështetëse si kontrolli kufitar, Inteligjenca, ILECU, njësia anti terror, njësia anti-bombë, etj.

---

<sup>39</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2737#>

<sup>40</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2652#>

<sup>41</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2433#>

<sup>42</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2751#>

<sup>43</sup> Smal Arms Control/Kontrolli i Armëve të Vogla

<sup>44</sup> Explosive Control/Kontrolli i Eksplozivëve



### **Pika Kontaktuese Nacionale (FFP)**

Ka për funksion grumbullimin e informatave dhe të dhënave statistikore nga institucionet relevante, analizimin dhe vlerësimin e të dhënave të mbledhura, si dhe hartimin e shpërndarjen e raporteve analitike për organet relevante dhe për Koordinatorin Nacional. Pika kontaktuese Nacionale shërben edhe si Pikë e Përhershme e kontaktit 24/7 për bashkëpunim ndërkombëtar në luftën kundër trafikimit të paligjshëm.

### **Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar (QKMK)**

Mekanizëm i vendosur në MPB, që ka për funksion bashkërendimin e aktiviteteve dhe operacioneve 24/7 që dalin nga kërkesat e autoriteteve të përfshira në MIK dhe ndërlidhjen me autoritetet tjera të zbatimit të ligjit sipas nevojës, duke ofruar mbështetje, lehtësuar shkëmbimin e informatave dhe rritjen e integritetit në mes të autoriteteve të përfshira në fushën e menaxhimit të kufirit shtetëror dhe atyre të zbatimit të ligjit.

**Njësia e Përbashkët për Inteligjencë, Analizë të Rrezikut dhe Kërcënimeve (NJPIARK)** - vepron në kuadër të QKMK e cila do të ketë për detyrë të ofrojë të dhëna inteligjence, të analizuar për sektorët e nivelit taktik, operacional dhe nivelit strategjik. Po ashtu në këtë pjesë është edhe **Grupi për Caktim dhe Koordinim të Detyrave (GCKD)** i cili do të marrë për sipër ndërlidhjen e strategjive mes MIK dhe AVL.

### **Agjencia e Kosovës për Forenzikë**

AKF mbështetë zyrat e Prokurorive dhe Ministrinë për Punë të Brendshme në përputhje me ligjin relevant. Përveç kësaj, AKF prodhon inteligjencën balistike për armët e zjarrit dhe municionin.

### **Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial**

Janë institucionet përgjegjëse për ndjekjen penale të kryesve, ndëshkimin adekuat të tyre, për konfiskimin e pasurisë dhe asetëve të fituara me anë të aktiviteteve kriminale.

### **Agjencia e Kosovës për Inteligjencë**

AKI bën identifikimin e kërcënimeve që rrezikojnë sigurinë e Kosovës. Kërcënim ndaj sigurisë së Kosovës konsiderohet kërcënim ndaj integritetit territorial, integritetit të institucioneve, rendit kushtetues, stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik. Pjesë e mandatit të AKI është edhe lufta kundër trafikimit të paligjshëm të armëve.

### **Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale**

Komisioni i pavarur për miniera dhe minerale do të bashkëpunojnë me MPB-në për zbatim adekuat të Ligjit për Përdorim Civil të Eksplozivëve

### **Ministria e Tregtisë dhe Industrisë**

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me Departamentin e Sigurisë Publike dhe Policinë e Kosovës, kontrollon kompanitë e përfshira në tregtinë me AVL dhe licencimin dhe mbikëqyrjen e kompanive për përdorimin e mallrave të dyfishtë.



### **Ministria e Drejtësisë**

MD përgatit dhe zhvillon legjislacionin në fushën e drejtësisë, vecanërisht tek Kodi Penal si dhe koordinon dhe zhvillon bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale.

### **Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës**

MFSK ka rolin e deminimit të eksplozivëve kur situata të raportimeve për gjetje ose kur qytetarët dorëzojnë vullnetarisht eksplozivë të ndryshëm. Gjithashtu ka rolin në lëshimin e pëlqimit për licencimin e kompanive që merren me PQV.

### **Ministria e Financave**

MF siguron që kostot financiare të aktiviteteve të strategjisë janë brenda kornizave buxhetore. Gjithashtu përmes Doganës, Njësisë së Inteligjencës Financiare dhe Administratës Tatimore, do të ndihmojë në forcimin e sigurisë së brendshme, parandalimin dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm.

### **Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**

MASHT luan rëndësishëm në fushën e parandalimit dhe vetëdijesimit nëpërmjet hartimit të kurrikulave, organizimit të aktiviteteve vetëdijesuese dhe aktiviteteve tjera jashtë-programore.

### **Ministria e Punëve të Jashtme**

MPJ ka rol në drejtim të dhënies së ndihmës për bashkëpunim ndërkombëtarë dhe të pjesëmarrjes në organizata rajonale dhe ndërkombëtare. Në bashkëpunim me MPB-në do të sigurojë zbatimin adekuat të embargove dhe Kodit Evropian të mirësjelljes të eksportit të armëve. Ministria e Punëve të Jashtme, do të jetë organ ekzekutiv për miratimin dhe lëshimin e raporteve të rregullta të progresit të Kosovës për organizatat relevante ndërkombëtare për kontrollin e AVL.

### **Ministria e Integritimit Evropian**

MIE siguron që korniza ligjore dhe politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës janë në harmoni me legjislacionin dhe politikat e BE-së.



## 6 Objektivat e Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta dhe Eksplozivëve

Strategjia për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta dhe Eksplozivëve ka këta objektive strategjik:

1. Zhvillim i mëtutjeshëm i legjislacionit dhe politikave;
2. Qasje gjithëpërfshirëse për zvogëlimin e rreziqeve nga armët dhe eksplozivët që cenojnë sigurinë publike;
3. Zhvillimi i mëtutjeshëm i kapaciteteve institucionale dhe hulumtuese;
4. Koordinimi ndër-institucional dhe rritje të bashkëpunimit ndërkombëtar.

### Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i mëtutjeshëm i legjislacionit dhe politikave

Aktivitetet në kuadër të këtij objektiwi përfshijnë:

**Ri shikimi i vazhdueshëm i Legjislacionit dhe politikave** – ka për qëllim të analizojë dhe ndryshojë legjislacionin primar dhe sekondar si dhe strategjitë e mekanizmat aktual dhe ti sinkronizojë ato me ndryshimet ligjore të BE-së si dhe planin e veprimit të Bashkimit Evropian. Në veçanti do të adaptohen dhe plotësohen ligjet si ai për Armët i cili do të plotësohen në përputhje me kërkesat e Direktivës së BE-së për Armët e Zjarrit dhe Rregulloren për De aktivizim të Armëve; Ligji për Pajisje për Qëllime të Veçanta dhe udhëzimet administrative; Ligji për përdorimin civil të Eksplozivëve të sinkronizohet me legjislacionin relevant të BE-s, në veçanti me legjislacionin për prekursorët si dhe Listën e eksplozivëve të lejuar (OKB); Do të tentohet që këto ligje dhe rregullore të sinkronizohen me Ligjin për Mallrat Strategjike (i sponsorizuar nga MTI). Mekanizmat zbatues, po ashtu do të plotësohen duke krijuar procedura standarde operimi për Mekanizmin e Koordinimit Nacional dhe procedurës standarde të veprimit për Pikën Nationale Kontaktuese (ILECU) sipas standardit ISACS 03.40<sup>45</sup> dhe ISACS 04.10<sup>46</sup>, si dhe hartimi Rregullores për Komitetin Drejtues të AVL-ve dhe Eksplozivëve.

**Hartimi dhe zbatimi i Legjislacionit dhe politikat për legalizimin e Armëve** – Ligji i sponsorizuar nga MPB i cili pritet të hyjë në fuqi në vitin 2017. Legalizimi i armëve është krijuar me qëllim të regjistrimit të armëve të paligjshme, dhe kështu të ndikohet në uljen e numrin të paligjshëm si dhe në rritjen e kontrollit ndaj armëve. Po ashtu legalizimi është veprimi i fundit para hartimit dhe shpalljes së Ligjit për dorëzim vullnetar.

**Hartimi dhe zbatimi i Legjislacionit dhe politikat për dorëzim vullnetar** – Ministria e Punëve të Brendshme do të hartojë dhe propozojë për miratim Ligjin për dorëzim vullnetar. Kjo politikë formulohet për të mundësuar dorëzimin e armëve, të cilat nuk mund të legalizohen dhe të cilat paraqesin rrezik për jetën, pronën dhe sigurinë publike. Ligji për dorëzimin vullnetar do ti ofrojë mundësi qytetarëve të Kosovës të dorëzojnë vullnetarisht armët duke përdorur të drejtën e amnistisë nga ndjekja penale.

---

<sup>45</sup> <http://www.smallarmsstandards.org/isacs/0340-en.pdf>

<sup>46</sup> <http://www.smallarmsstandards.org/isacs/0410-en.pdf>





**Politika për Menaxhim efikas të depove** – do të hartohen në mënyrë që armët, municioni, eksplozivët dhe prekursorët të jetë nën kontroll të rreptë dhe të gjurmueshëm. Do të kërkohet verifikim më i detajuar i personelit që ka qasje në depo që mbajnë këto materiale, si nga institucionet qeveritare edhe ato private. Ndërtimi i Depos Nacionale i realizuar si projekt kapital nga MPB do të bëhet funksionale dhe do të ofrohet për përdorim agjencive ekzekutive të cilat konfiskojnë armë, municion, eksplozive dhe materiale të tjera të rrezikshme.

**Ri-vlerësimi i Marrëveshjeve aktuale** – do të bëhet me qëllim që të ketë mundësi të përshtaten me ambientin dhe fenomenet të cilat mund të ndryshojnë. Kjo do të aplikohet në sferën ndër-institucionale dhe ndërshtetërore. MPB ka rreth 8 Marrëveshje të ndryshme të bashkëpunimit policor me shtete të veçanta, në të cilat rregullohet bashkëpunimi edhe për rastet e veprave penale me armë, municion e eksplozive. Do të analizohet kërkesa për Marrëveshje të reja varësisht nga nevojat që paraqiten nga Agjencitë e Sigurisë për luftimin e trafikimit.

**Krijimi i platformës për raportim të shpejtë i humbjeve dhe vjedhjeve të armëve, eksplozivëve dhe prekursorëve të tyre** – është e rëndësishë së veçantë në rrethanat aktuale të sigurisë. Humbja apo vjedhja e eksplozivit apo prekursorëve nga tregu apo operatorët e ligjshëm shtetëror apo privat, mund të paraqes rrezik serioz. Lajmërimi i shpejtë, është i rëndësishëm për sektorë të veçantë të sigurisë. Departamenti për Siguri Publikë do të hartojë një propozim për formën dhe procedurën e raportimit dhe të shpërndarjes së informacionit duke u bazuar në “Komunikatën e Komisionit për Parlamentin dhe Këshillin e BE-së”<sup>47</sup>.

**Objektivi Strategjik 2:** Qasje gjithëpërfshirëse për zvogëlimin e rreziqeve nga armët dhe eksplozivët që cenojnë sigurinë publike

Aktivitetet në kuadër të këtij objektivi përfshijnë:

**Hartimi i planeve dhe zbatimi i operacioneve** – do të zbatohet për të ulur numrin e armëmbajtjeve pa leje, si dhe të adresojë fenomenin e “festimit me armë” i cili është i dukshëm/shfaqet në Kosovë në muajt verorë dhe në festat e fund vitit.

**“Patrullimi kibernetik”** – Patrullimi kibernetik aplikohet nga Policia e Kosovës ndaj faqeve sociale në internet, dhe do të bëhen përpjekje për t’i ngritur kapacitetet edhe në drejtim të parandalimit dhe zbulimit të tregtisë “online” e cila është e ndaluar në Kosovë. Gjithashtu do të ngritën kapacitete për të bërë të mundur që ky “patrullim” të bëhet edhe në “dark web”<sup>48</sup>.

**Hetime të përbashkëta dhe të sinkronizuara**– nga specialistë të njësisë kundër-terrorit, kundër drogës, policisë kufitare, kundër pastrimit të parasë, kundër trafikimit me armë-eksplozive dhe kundër trafikimit me qenie njerëzore. Do të aplikohet qasja kundër luftës ndaj armëve të paligjshme

---

<sup>47</sup>Po aty.

<sup>48</sup> Trafikimi online i armëve përmendet në disa artikuj ndërkombëtar:

CNN (2016) - <http://edition.cnn.com/2016/08/10/us/declassified-illegal-online-weapons-trade/>

CBC (2013) - <http://www.cbc.ca/news/technology/welcome-to-the-dark-web-a-haven-for-illegal-trafficking-1.1357813>

Scientific American (2015) - <https://www.scientificamerican.com/article/human-traffickers-caught-on-hidden-internet/>



dhe grupeve të organizuara kriminale. Për armët e konfiskuara nga këto operacione do të aplikohet metoda e gjurmimit të armës, municionit apo eksplozivit për të identifikuar rrugët transportuese.

**Qasja kundër trafikimit me AVL dhe Eksplozive të përfshihet edhe në takimet nacionale, lokale dhe rajonale** – të cilat zhvillohen si rezultat i qasjes strategjike dhe operacionale nga Menaxhimi i Integruar i Kufirit/MIK, Strategjia kundër terrorizmit, Policimi i udhëhequr nga Inteligjenca, etj. Kjo qasje mundëson luftën kundër trafikimit të paligjshëm që hyjnë në dhe dalin nga territori i Republikës së Kosovës.

**Inspektive, kontrole dhe raportime të rregullta statistikore** – do të prodhojë Departamenti për Siguri Publike i Ministrisë së Punëve të Brendshme, mbi tregtimin e ligjshëm dhe gjendjen e armëve, eksplozivëve dhe municionit në depot ekzistuese shtetërore dhe private. Të dhënat do të bëhen publike deri në atë shkallë sa nuk rrezikohet “publikimi i të dhënave konfidenciale”. Inspektimi i depove shtetërore dhe private do të bëhet me qëllim të certifikimit sipas standardit të IATG.

**Ngritja e platformës për diskutim dhe bashkëpunim me sektorin privat dhe furnitorët e tyre** – do të ketë për qëllim ngritjen e përgjegjesisë, bashkëpunimit dhe vetëdijësimin mbi procedurat ligjore për **kontrollin dhe verifikimin e dërgesës**<sup>49</sup>. Tek eksplozivet do të aplikohet metodologjia dhe aktivitetet e kërkuara, aty ku është e mundur, sipas “Komunikatë e Komisionit për Parlamentin dhe Këshillin e BE-së”<sup>50</sup>.

**Hartimi i listës për monitorimin e transaksioneve “për materialet të cilat nëse kombinohen mund të krijojnë eksploziv artizanal”** – do të jetë politikë e cila do të udhëhiqet nga Departamenti për Siguri Publike. Do të analizohen praktikat dhe modelet ekzistuese dhe do të kërkohet mbështetje teknike nga ekspertë dhe mekanizma adekuat brenda dhe jashtë vendit.

**Mbledhja, sistemimi, analizimi dhe publikimi i të dhënave statistikore për rastet e veprave penale me armë, municion dhe eksplozive** – ka për qëllim të paraqes trendët e veprave dhe ti krahasojë me politikën e dënimeve. Ky krahasim do të shërbejë për të vlerësuar “nëse politika e dënimeve” ka ndonjë ndikim në uljen apo ngritjen e trendëve të veprave penale, duke përdorur metodën **shkak – pasojë**. Në një formë, kjo analizë do të shërbejë si parandalim dhe do të dërgohet për shqyrtim Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial. Ky cikël analizë – rekomandim për shqyrtim të politikës të dënimeve – analizë e trendëve, do të jetë cikël i vazhdueshëm, por jo më shpesh se 2 herë dhe jo më pak se 1 herë gjatë vitit kalendarik. Pika nacionale kontaktuese (ILECU) do të hartojë analizën.

**Fushata vetëdijësuese dhe avokuese** – do të organizohen nga Institucionet shtetërore dhe do të kërkohet bashkëpunim me Organizata jo Qeveritare. Do të kërkohet edhe përfshirje të komunitetit artistik me qëllim të rritjes së vetëdijës mbi rrezikun ndaj armëve. Do të kërkohet bashkëpunim i

<sup>49</sup>Udhëzimi Administrativ Nr.07/2011 për përcaktimin e procedurave për import dhe përdoruesin e fundit, eksportin e përkohshëm dhe masat e sigurisë gjatë transportit të PQV-ve - <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/UA%2007%202011.pdf>

<sup>50</sup>Komisioni Evropian (2007) - <http://eur-lex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52007DC0651&from=EN>



vecantë me Rrjetin e Grave të Kosovës, sepse gratë janë viktimat të armëve, ndërsa të dhënat në hulumtime të opinionit publik (2015) tregojnë se edhe gratë “mbështesin mbajtjen e një armë në shtëpi”.

**Objektivi Strategjik 3:** Zhvillimi i Kapaciteteve institucionale dhe hulumtuese

Aktivitetet në kuadër të këtij objekti përfshijnë:

**Trajnimi për menaxhimin e Depove Shtetërore dhe Private** - do të organizohen nga MPB, me qëllim që të ngriten dhe unifikohen standardet nacionale si dhe ngritja e kapaciteteve menaxhuese në sektorin shtetëror dhe në sektorin privat.

**Funksionalizmi i Depos Shtetërore** - do të jetë një prej aktiviteteve të Strategjisë. Depo shtetërore është ndërtuar për të mundësuar deponimin e materialeve të konfiskuara nga Agjencitë përkatëse të Qeverisë së Kosovës. Do të bëhet një plan për të bartur autorizimet për menaxhimin ditor të depos shtetërore. Do të analizohet se cili autoritet është më i përshtatshëm për të marrë nën menaxhim depon shtetërore, e cila është ndërtuar për të deponuar, armë, municion, eksplozive dhe fishekzjarrë të konfiskuara.

**Të ngritën kapacitete analitike dhe statistikore** - për sektorë të vecantë si ILECU, DSP dhe Forenzika të cilët do të bëjnë “intelligence analysis” “ballistic intelligence”, etj., të cilët gjatë analizës do të aplikojnë edhe metodologjinë e bazuar në ndarje gjinore.

**Të hartohet lista e nevojave për pajisje dhe mjete pune për Policinë Kufitare, doganave dhe agjencive për detektimin e armëve, municionit dhe eksplozivit për mbikëqyrjen dhe kontrollin kufitar** - do të bëhet me qëllim që të ketë një prioritetizim në kërkesat buxhetore nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe po ashtu do të ndihmojë në hartimin e projekteve për financim nga BE apo shtete të veçanta.

**Objektivi Strategjik 4:** Koordinimi ndër-institucional dhe rritje të bashkëpunimit ndërkombëtar

Aktivitetet në kuadër të këtij objekti përfshijnë:

**Themelimi i mekanizmit raportues dhe të koordinimit të aktiviteteve të Strategjisë** - do të themelohet për të garantuar koordinimin ndër-institucional dhe për vlerësimin e zbatimit të aktiviteteve të Strategjisë. Do të aplikohet standardi ISACS 03.40, aty ku është e mundur.

**Raportimi për Organizata ndërkombëtare (relevante)** - Koordinatorin Nacional do të hartojë raporte dhe, nëpërmjet MPJ, do të shpërndajë ato për organizata të specializuara që veprojnë nën OKB, BE, OSCE dhe të tjera.

**Intensifikimi i bashkëpunimit ndërmjet Pikës kontaktuese (ILECU) me pikat kontaktuese rajonale dhe ndërkombëtare** - do të bëhet me qëllim që të rritet kontributi i Republikës së Kosovës në shkëmbimin e të dhënave dhe në pjesëmarrjen e operacioneve të përbashkëta që kanë për qëllim luftimin e trafikimit ndërkufitar në fushën e AVL dhe Eksplozivëve.



**Fuqizimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimi i përvojave me Agjencitë relevante të BE-së -** Republika e Kosovës është përgatitur të koeprojë dhe shkëmbejë informacione, si dhe do të hulumtojë modalitetet për bashkëpunim të mëtutjeshëm me EUROPOL, FRONTEX dhe SELEC për të koontribuar në luftimin ndër-kufitar të armëve dhe eksplozivëve.

**Hulumtimi i modaliteteve të bashkëpunimit me Interpol në iArms dhe iBIN -** Republika e Kosovës do të hulumtojë mundësitë për të qenë e aftë të shkëmbejë të dhëna për armët e vjedhura, të humbura në sistemin iARMS dhe të të dhënave balistike me iBIN të INTERPOL-it.

**Bashkëpunimi me SEESAC, SEEFEN, SEEFEG -** Republika e Kosovës do të vazhdojë pjesëmarrjen dhe të kontribuojë në organizatat rajonale, të lartëpërmendura. Bashkëpunimi me SEESAC dhe grupeve të saj të veçanta do të jetë i rëndësishëm primare.



## **7 Implementimi, monitorimi dhe vlerësimi i Strategjisë**

### **7.1 Roli i sistemit të monitorimit**

Procesi i implementimit të Strategjisë do të synojë përmbushjen e objektivëve strategjikë dhe aktiviteteve. Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve do të jetë pjesë përbërëse e procesit të Strategjisë, nëpërmjet komitetit drejtues. Monitorimi dhe vlerësimi janë mjete për matjen e përparimit në raport me objektivat e caktuar, për të vlerësuar nevojën e përcaktimit të rregullave të menaxhimit, në veçanti të aktiviteteve.

Procesi i monitorimit do të udhëhiqet nga Koordinatori Nacional nëpërmjet Komitetit Drejtues, i cili do të ketë pjesëmarrje të gjerë dhe do të hartojë Raportin e Përgjithshëm në muajin janar të çdo viti.

### **7.2 Kapacitetet institucionale për monitorim e vlerësim**

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit do të zgjerohet për të mbuluar të gjitha institucionet përgjegjëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Strategji dhe Plan të Veprimit:

- Koordinatori Nacional, si institucion udhëheqës do të monitorojë indikatorët e Strategjisë. Në muajin mars të çdo viti, ai do të përgatisë një raport progresi për Presidentin, Kryeministrin, Ministrin e Punëve të Brendshme, Këshillin Për Siguri Kombëtare, Ministrin e Financave dhe palët e tjera me interes të veçantë;
- Ministritë dhe institucionet e tjera të shënuara në plan të veprimit do të jenë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve sipas Ministrive dhe Agjencive të linjës. Këto institucione do të dorëzojnë raportet e tyre periodike tek Koordinatori Nacional ashtu që raportet dhe të dhënat të standardizohen;
- Organizatat joqeveritare të cilat në mënyrë aktive marrin pjesë në procesin e zbatimit dhe monitorimit të strategjisë, do të paraqesin vlerësimet dhe rekomandimet e tyre.

### **7.3 Indikatorët për monitorim dhe vlerësim**

Plani i aktiviteteve të Strategjisë përban 4 Objektiva Strategjik, 27 Aktivitete dhe 40 Indikatorë. Në këtë pjesë kemi shkëputur indikatorët kryesorë të cilët ndihmojnë vlerësimin e përgjithshëm.

1. Legjislacioni i harmonizuar me atë të BE-së dhe adreson kërkesat vendore për rritjen e sigurisë publike, pas hyrjes në fuqi të Strategjisë;
2. Kapacitetet analitike dhe hulumtuese janë ngritur dhe funksionale;
3. Plani vjetor Legjislativ i MPB reflekton kërkesat për ndryshime të legjislacionit primar dhe sekondar;
4. Strukturat janë themeluar dhe funksionale (Koordinatori, Komiteti Drejtues);



5. Numri i personelit të trajnuar dhe verifikuar për menaxhimin e depove të armëve, municionit dhe eksplozivëve;
6. Janë certifikuar depot e armëve, municionit dhe eksplozivëve sipas standardit të IATG;
7. Numri i armëve dhe eksplozivëve të legalizuara dhe të dorëzuara vullnetarisht;
8. Numri i të arrestuarve dhe numri i armëve, eksplozivëve të konfiskuar nga operacionet;
9. Numri i rasteve të gjurmimit të armëve të konfiskuara nga operacionet;
10. Numri i aktiviteteve publike – sociale të organizuara nga MPB-PK që përfshijnë vetëdijesimin e grupeve të caktuara që aplikojnë edhe metodologjinë gjinore;
11. Numri i rasteve për vërtetim të dyfishtë të lejeve të importit;
12. Plani i inspektimeve dhe raportet monitoruese;
13. Raportet statistikore vjetore dhe numri i raporteve publikuara;
14. Lista për identifikimin e nevojave për mbikëqyrjen kufitare ;
15. Numri i trajnimeve të mbajtura;
16. Numri i pjesëmarrësve të certifikuar;
17. Numri i aktiviteteve bashkëpunuese me agjencitë relevante të BE-së;
18. Pjesëmarrja në takimet rajonale dhe iniciativat e përbashkëta.



## 8 **Plani i Veprimit 2017-2021**

Plani i Veprimit reflekton përputhshmërinë e tij me kornizën e përgjithshme të Strategjisë. Plani i Veprimit do të rishikohet në fund të çdo viti në mënyrë që të sigurohet zbatueshmëria e Strategjisë dhe harmonizimi me trendet vendore dhe ndërkombëtare.

Plani i Veprimit për implementimin e kësaj strategjie përfshin:

- Objektivët strategjikë;
- Aktivitetet për implementim;
- Specifikimin e kornizës kohore për përmbushjen e secilit aktivitet;
- Përcaktimin e burimeve të nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve;
- Përcaktimin e institucioneve përgjegjëse dhe përkrahëse për objektivin dhe aktivitetet e caktuara;
- Përcaktimin e indikatorëve për implementimin e secilit aktivitet.



## STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR KONTROLLIN E ARMËVE TË VOGLA, TË LEHTA DHE EKSPLOZIVËVE 2017 – 2021

### Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i mëtutjeshëm i legjislacionit dhe politikave

Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Buxheti	Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Indikatorët e performancës
1.1.	Ri-shikimi i legjislacionit për armët dhe eksplozivët si dhe i mandatit për mekanizmat aktual.	2017	Kosto Administrative	MPB	AKF PK QKMK Ministria e drejtësisë Prokuroria Ministria e Bujqësisë MTI AVUK	Legjislacioni i harmonizuar me legjislacionin e BE-së, standardet ndërkombëtare dhe kërkesat vendore për rritjen e sigurisë publike; Kapaciteti i Pikës kontaktuese është ngritur; Plani vjetor Legjislativ i MPB përmban kërkesat për ndryshime të legjislacionit.
1.2.	Ri - vlerësimi i Marrëveshjeve aktuale ndër-institucionale dhe ndërshtetërore të Kosovës si dhe propozimi për Marrëveshje të reja.	2017 - 2019	Kosto Administrative	MPB PK	Qeveria Kuvendi Këshilli Sigurimit Kombëtar	Propozim - ndryshimet për Marrëveshjet aktuale; Propozimet për Marrëveshje të reja;
1.3.	Politika për menaxhimin efikas të depove të armëve dhe eksplozivëve si dhe procedura të shtrënguara për kufizim të qasjes së pa-autorizuar	2019	Kosto Administrative	MPB PK	Qeveria Kuvendi Këshilli Sigurimit Kombëtar	Numri i akteve ligjore të miratuara; Numri i depove të certifikuara sipas standardit IATG;





Strategjia dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta dhe Eksplozivëve 2017 – 2021

						Numri i zyrtarëve të verifikuar; Projektet e propozuara për investime kapitale.
1.4.	Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe legjislacionit për legalizimin e armëve dhe dorëzim vullnetar.	Në vazhdimësi	30.000 dhe Donacion	MPB DSP PK AKF QKMK	MPJ Presidenti Agjencitë që posedojnë dhe deponojnë armë dhe eksplozive	Numri i kërkesave dhe armëve të legalizuara. Aktet Ligjore të miratuara; Plani për dorëzim vullnetar i hartuar; Numri i armëve dhe eksplozivëve të dorëzuara vullnetarisht
1.5	Krijimi i platformës për raportim dhe njoftim të shpejtë i humbjeve apo vjedhjeve të armëve dhe eksplozivëve.	2017	Kosto Administrative	MPB DSP PK Departamentet IT	Pika kontaktuese Agjencitë Ekzekutive Sektori privat	
<b>Objektivi Strategjik 2:</b> <b>Qasje gjithëpërfshirëse për zvogëlimin e rreziqeve nga armët dhe eksplozivët që cenojnë sigurinë dhe rendin publik</b>						
<b>Nr.</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Afati kohor</b>	<b>Buxheti</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Institucionet mbështetëse</b>	<b>Indikatorët e performancës</b>
2.1.	Hartimi dhe zbatimi i planeve operative për konfiskimin e armëve dhe eksplozivëve të paligjshëm.	Në vazhdimësi	Kosto Administrative	PK Dogana	MPB AKI	Planet e hartuara dhe numri i operacioneve të zbatuara; Numri i armëve, eksplozivëve të konfiskuar nga operacionet; Numri i rasteve të gjurmimit të armëve të



Strategjia dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta dhe Eksplozivëve 2017 – 2021

						konfiskuara nga operacionet.
2.2	Fushata të vetëdijesimit dhe avokimit; Shënimi i datave ndërkombëtare; Bashkëpunimi me OJQ, komunitete lokale, komunitetit artistik dhe rrjetit të grave të Kosovës me qëllim ngritjen e vetëdijes kundër posedimit dhe përdorimit të paligjshëm të armëve dhe mjeteve shpërthyes;	Në vazhdimësi	30.000 në vit Donatorë	MPB PK Gratë në uniformë	OJQ Rrjeti i grave të Kosovës Komuniteti artistik Ministria e kulturës, rinisë dhe sporteve Teatrot kombëtare dhe private Media	Numri i fushatave dhe aktiviteteve publike; Numri i projekteve të propozuara dhe realizuara për vetëdijesimin e publikut apo grupeve të cënueshme; Numri i aktiviteteve publike – sociale të organizuara nga MPB-PK që përfshijnë vetëdijesimin e grupeve të caktuara që aplikojnë edhe qasjen gjinore.
2.3	Ngritja dhe funksionimi i platformës për diskutim dhe bashkëpunim me sektorin privat në Kosovë dhe furnitorët e tyre – arme, eksplozive dhe prekursorët.	Në vazhdimësi	3,000 në vit Donatore	Koordinatori Nacional MPB	DSP Pika kontaktuese - ILECU PK QKMK AKF	Numri i takimeve të mbajtura; Numri i rasteve për vërtetim të dyfishtë të lejeve të importit
2.4	Inspektime, kontrole dhe raportime të rregullta statistikore mbi tregtimin e ligjshëm dhe gjendjen e armëve, eksploziveve dhe municionit në depot ekzistuese shtetërore dhe private;	Periodike dhe raport vjetor	Kosto Administrative	DSP PK Pika kontaktuese - ILECU	Dogana FSK Agjencitë ekzekutive	Plani i inspektimeve dhe raportet monitoruese; Raportet statistikore
2.5	Hartimi i Listës për identifikimin dhe monitorimin e transaksioneve “te	2018	Kosto Administrative	MPB PK Dogana	Ekspertize ndërkombëtare Agjencitë ekzekutive	Lista e hartuar



Strategjia dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta dhe Eksplozivëve 2017 – 2021

	materialeve te cilat nëse kombinohen mund te krijojnë eksploziveve artizanal”.				Njësia e dominimit AKF PK AKI AKPM	
2.6	Aplikimi i “patrullimit kibernetikë edhe ne sferën e trafikimit te paligjshëm me arme dhe eksplozive.	2017	Kosto Administrative	PK	AKI QKMK GCKD	Numri i rasteve te zbuluara apo hetuara
2.7	Mbledhja, sistemimi, analiza dhe publikimi i te dhënave statistikore për rastet e ndjekjes dhe dënimit për vepra penale me arme, municion dhe eksplozive.	Në vazhdimësi	Kosto Administrative	Pika kontaktuese - ILECU	Këshilli Prokurorial Këshilli Gjyqësor MPB PK AKF QKMK Dogana	Numri i raporteve te analizuara; Numri i raporteve publikuara.
2.8	Te përfshihet qasja kundër posedimit te paligjshëm me arme dhe eksplozive ne takimet e nivelit nacional, lokal dhe rajonal ne strategjitë dhe grupet operacionale dhe strategjike si Menagjimi i integruar i kufirit, kundër radikalizmit qe shpie ne terrorizëm, Policimi i udhëhequr nga intelijenca dhe Strategjia kundër terrorizmit.	Në vazhdimësi	Kosto Administrative	MPB PK	AKI QKMK GCKD Koordinatorët Nacional	Numri i takimeve te mbajtura Raportet analitike mujore përfshijnë edhe armët dhe eksplozivët e paligjshëm. Hartimi i vlerësimeve strategjike
2.9	Hetime te përbashkëta terrorizmi, kibernetika, kontrolli kufitar ,pastrimi i parasë, droga, trafikimi me arme, eksplozive dhe trafikimi me qenie njerëzore.	Në vazhdimësi	Kosto administrative	PK	Prokurori AKI NjIF Dogana	Numri i operacioneve te përbashkëta Numri i te arrestuarve dhe konfiskimeve



<b>Objektivi Strategjik 3</b>						
<b>Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe hulumtuese</b>						
<b>Nr.</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Afati kohor</b>	<b>Buxheti</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Institucionet mbështetëse</b>	<b>Indikatorët e performancës</b>
3.1	Të ngritën kapacitete analitike dhe statistikore ne ILECU (Focal Point) , DSP (SACONS & Explocon) dhe Forenzike te cilët aplikojnë edhe metodologjinë e bazuar ne ndarje gjinore.	Në vazhdimësi	Donatorë	MPB	AKF PK DSP AKSP	Numri i trajnimeve te mbajtura Numri i raporteve te hartuara
3.2	Trajnimi për menaxhimin e depove shtetërore dhe private;	2018-2020	Donatorë	MPB	AKF PK DSP AKSP Agjencitë Ekzekutive Sektorit Privat	Numri i pjesëmarrësve të certifikuar
3.3	Funksionalizimi i depos shtetërore	2018	Kosto Administrative	MPB DSP	PK	Depo shtetërore është funksionale.
3.5	Hartimi i listës se nevojave për pajisje dhe mjete te punës për Policinë kufitare, doganave dhe agjencive për detektimin dhe mbikëqyrjen e vijës se gjelbër kufitare.	2017	Kosto administrative	MPB	PK Dogana QKMK Agjencitë ekzekutive	Lista e nevojave e hartuar.
<b>Objektivi Strategjik 4:</b>						
<b>Koordinimi ndër-institucional dhe rritje të bashkëpunimit ndërkombëtarë</b>						
<b>Nr.</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Afati kohor</b>	<b>Buxheti</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Institucionet mbështetëse</b>	<b>Indikatorët e performancës</b>



Strategjia dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta dhe Eksplozivëve 2017 – 2021

4.1	Themelimi i mekanizmit raportues dhe te koordinimit te aktiviteve te Strategjisë.	2017	Kosto Administrative	Koordinatori Nacional	DL	Mekanizmi i themeluar dhe funksional
4.2	Hartimi i Rregullores se punës te mekanizmit raportues dhe koordinues te Strategjisë.	2017	Kosto Administrative	Koordinatori Nacional	DL	Rregullorja e punës e aprovuar
4.3	Raportimi për organizata ndërkombëtare (relevante).	Në vazhdimësi	Kosto Administrative	Koordinatori Nacional Pika kontaktuese - ILECU	Mekanizmi raportues dhe koordinues i Strategjisë	Numri i raporteve te dërguara ne organizatat relevante.
4.4	Intensifikimi i bashkëpunimit i pikës kontaktuese (ILECU) me pikat kontaktuese rajonale dhe ndërkombëtare.	Në vazhdimësi	Kosto Administrative	Koordinatori Nacional Pika kontaktuese - ILECU		Numri i pikave kontaktuese me te cilat bashkëpunohet.
4.5	Fuqizimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimi i përvojave me Agjencitë relevante te BE-se	Në vazhdimësi		Ministri - MPB Ministri - MPJ	Koordinatori Nacional Pika kontaktuese - ILECU	Numri i aktiviteve bashkëpunuese me agjencitë relevante te BE-se
4.6	Hulumtimi i modaliteteve të bashkëpunimit me Interpol ne iARMS dhe iBIN.	Në vazhdimësi		Ministri - MPB Ministri - MPJ	Koordinatori Nacional Pika kontaktuese - ILECU	Numri i rasteve te shkëmbimit te informacioneve.
4.7	Bashkëpunimi me SEEFEN, SEEFEG, dhe SEESAC.	Në vazhdimësi		Koordinatori Nacional Pika kontaktuese - ILECU MPJ MD	Dogana Prokuroria	Pjesëmarrja ne takimet rajonale dhe iniciativat e përbashkëta